



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË  
KOMUNËS SË PODUJEVËS**

**PËR VITIN 2019**

**Prishtinë, qershor 2020**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Podujevës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer *Elvir Krasniqi*, udhëheqës ekipi dhe anëtarëve të ekipit *Ejup Simnica dhe Senver Morina*, nën menaxhimin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit *Astrit Bllaca*.


## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore .....	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja.....	31
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	34

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Podujevës për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



### Konkluzionet

Pasqyrat financiare vjetore ishin përgatitur në harmoni me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme, megjithatë nevojiten përmirësime tek mbledhjen e të arkëtueshmeve. Gjithashtu, kërkohet angazhim më i shtuar për përmirësim të mëtejshëm për të zvogëluar numrin e të angazhuarve me marrëveshje të veçanta për punë jo specifike, respektimin e rregullave të prokurimit, subvencioneve, të pasurisë dhe obligimeve.

Komuna i është përgjigjur pozitivisht rekomandimeve të vitit paraprak, ku është vërejtur një angazhim i shtuar në adresimin e tyre. Prej 20 rekomandimeve, 10 rekomandime janë zbatuar, një në proces, tri nuk janë adresuar ende, derisa gjashtë rekomandime janë të mbyllura.

### Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm<sup>1</sup>

**Opinion i pamodifikuar**

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

### Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës, gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

## Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

---

# 1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve së Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

## 1. Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

### Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime)dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës

### Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Podujevës kishte shpenzuar 84% të buxhetit final për vitin 2019, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm, megjithëse sfidë mbetet niveli i realizimit të investimeve kapitale, të cilat ishin realizuar 69%. Vlen të theksohet se rreth 62% e buxhetit të investimeve kapitale ishte shpenzuar në dy muajt e fundit të 2019. Kjo paraqet një tregues se në projektet kapitale ka vonesa si tek proceset e prokurimit ashtu edhe në kryerjen e punëve. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme, megjithatë nevojiten përmirësime tek mekanizmat për arkëtimin e të hyrave dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve.

#### 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:



**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>27,381,619</b>	<b>28,223,622</b>	<b>23,612,094</b>	<b>84</b>	<b>18,815,507</b>	<b>18,356,287</b>
Granti i Qeverisë – Buxheti	20,210,226	20,210,225	19,751,426	98	17,719,674	16,602,523
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup> –	0	677,838	426,914	63	286,441	692,483
Të hyrat vetjake <sup>4</sup>	1,588,176	1,588,176	751,272	47	643,913	1,013,791
Donacionet e brendshme	0	140,135	29,550	21	-	2,150
Donacionet e jashtme	0	200,404	199,872	100	141,141	45,340
Financim nga huamarrja	5,583,217	5,406,844	2,453,060	45	24,338	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 842,003€. Kjo rritje është rezultat i bartjes i të hyrave vetanake prej 677,838€, donacioneve të brendshme 140,135€, donacionet e jashtme 200,404€ si dhe zvogëlimi i financimit nga huamarrja për 176,374€.

Në vitin 2019, Komuna ka shpenzuar 84% të buxhetit final ose 23,612,094€, me një zvogëlim prej 2% krahasuar me vitin 2018. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>27,381,619</b>	<b>28,223,622</b>	<b>23,612,094</b>	<b>84</b>	<b>18,815,507</b>	<b>18,356,287</b>
Pagat dhe Mëditjet	12,142,542	12,224,163	11,851,579	97	11,763,934	11,443,726
Mallrat dhe Shërbimet	2,178,773	2,032,631	1,892,718	93	1,479,775	1,045,464
Shërbimet komunale	400,000	400,000	395,150	99	321,170	320,572
Subvencionet dhe Transferet	610,000	685,015	566,758	83	506,581	646,681
Investimet Kapitale	12,050,304	12,881,813	8,905,889	69	4,744,047	4,899,844

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti për paga dhe mëditje ishte rritur përmes vendimit të Kuvendit Komunal (KK) nga të hyrat vetanake për 81,621€, për të mbuluar deficitin e buxhetor të kësaj kategorie tek arsimit mesëm dhe sektori i shëndetësisë primare (për pagesa të kujdestarive);
- Kategoria e mallrave dhe shërbimeve kishte zvogëlim të buxhetit në vlerë prej 146,142€. Buxheti për këtë kategori ishte rritur nga të hyrat vetanake për 37,921€ dhe nga donacionet e jashtme për 2€. Pastaj kjo kategori është zvogëluar për 184,065€ prej fondeve të huamarrjes;
- Rritja e buxhetit subvencioneve dhe transfereve për 75,015€, përfshin të hyrat e bartura nga viti paraprak për 70,015€ si dhe donacionet e brendshme për 5,000€ nga participimi i qytetareve në projekte; dhe
- Buxheti për shpenzime kapitale ishte rritur për 831,509€, si rezultat i të hyrave të bartura nga viti kaluar në vlerë 553,296€, donacioneve të jashtme prej 200,401€, donacioneve të brendshme për 70,120€ dhe financimi nga huamarrja për 7,692€. Buxheti ishte shpenzuar 8,905,889€ apo 69% për shkak se financimi nga huamarrja ishte paraparë të shpenzohet për vitin 2019 dhe vitin 2020.

#### Çështja A1 - Keq klasifikim i shpenzimeve

**Gjetja** Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Dy pagesa ishin ekzekutuar nga thesari në kategori të gabuar në vlerë 33,558€. Vlera 31,128€ është paguar nga kategoria e investimeve kapitale për kompensimin e pagave të një punëtoreje të arsimit të larguar nga puna pa bazë ligjore si dhe vlera 2,430€ është paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve për kompensimin e tri pagave jubilarë tri paga me rastin e pensionimit. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte planifikuar mjete të mjaftueshme në kategorinë e pagave.

**Ndikimi** Klasifikimi jo i rregullt i shpenzimeve, ka shkaktuar paraqitje jo e drejt të shpenzimeve në Pasqyrat Financiare si dhe ka ndikuar që mjetet të mos shpenzohen sipas planit buxhetor.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

## 2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2019 ishin në vlerë 1,204,633. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

**Tabela 3. Të hyrat(në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat totale	1,588,175	1,588,175	1,204,633	76	1,107,302	1,198,727
Të hyrat tatimore	510,000	510,000	441,455	87	428,323	373,613
Të hyrat jo tatimore	1,078,175	1,078,175	763,178	71	678,979	825,114

Nga të hyrat vetjake të planifikuara, komuna kishte arritur të arkëtoj 76%, dhe vërehet një trend pozitiv në arkëtimin e të hyrave nga viti i kaluar. Kemi testuar 14 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë.

## 2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 12,142,542€, prej tyre ishin shpenzuar 11,851,579€ Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1,980 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,921. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 106 punëtorë të rinj. Ne kemi testuar 49 mostra për teste substanciale si dhe shtatë mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

## Çështja B1 - Mangësi tek kontratat për shërbime të veçanta

**Gjetja** Sipas neni 10 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti dhe sipas neni 12, pika 4, të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Komuna kishte angazhuar 30 persona me kontrata për punë dhe detyra specifike, ku 23 prej tyre punonin për periudhën kohore më të gjatë se katër (4) muaj brenda një viti. Po ashtu, kishte angazhuar nëntë persona përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta për të cilët nuk ishte zbatuar një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Zyrtarët punonin, si infermierë, zyrtar për të dhëna, roje, punëtorë teknik, etj. Këto pozita konsiderohen si pozita të rregullta të punës e jo si detyra specifike siç janë cilësuar nga ana e komunës. Sipas komunës kjo ishte pasojë e mungesës së pozitave të aprovuara në planifikimin e buxhetit, mirëpo komuna ka pasur të aprovuar me ligjin e buxhetit 1,980 pozita, ndërsa në fund të vitit numri i të punësuarave ishte 1,921 në PVF-ve të komunës.

**Ndikimi** Mbulimi i pozitave me marrëveshje të përkohshme dhe tejkalimi i afateve ligjore rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rritë pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi meritator.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për detyra specifike të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se katër muaj. Po ashtu, pozitat e rregullta të punës të mos mbulohen me kontrata për detyra specifike dhe marrëveshjeve për shërbime të veçanta. Gjithashtu duhet të zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit për marrëveshjet për shërbime të veçanta.

### 2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shpenzimet komunale ishte 2,432,631€, prej tyre ishin shpenzuar 2,287,868€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet komunale, derivatet dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, mirëmbajtje të rrugëve, servisimi i veturave, furnizime mjekësore etj. Ne kemi testuar 27 mostra për teste substanciale në vlerë 213,374€ si dhe shtatë mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

## 2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 685,015€, prej tyre ishin shpenzuar 566,758€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencionimin e fermerëve, organizatave joqeveritare (OJQ), bursa të studentëve dhe nxënësve, mbështetje individuale tek shëndetësia si dhe mbështetje për aktivitete kulturore dhe sociale, etj. Kemi testuar shtatë mostra për teste substanciale në vlerë 176,710€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

### Çështja A2 - Mungesa e planit të subvencionimit të OJQ-ve

**Gjetja** Sipas nenit 6 të rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin planin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Komuna nuk kishte përgatitur plan vjetor për subvencionimin e OJQ-ve i cili do duhej të dorëzohet pranë zyrës së Kryeministrit. Kjo kishte ndodhur pasi që Zyrtari Kryesor Administrativ nuk kishte deleguar përgjegjësi për hartimin e planit për financim të OJQ-ve tek përgjegjësit e programeve që bëjnë shpërndarje të subvencioneve.

**Ndikimi** Mungesa e planit për financimin e OJQ-ve, mund të ndikojë që të financohen projekte me më pak prioritet, ndërsa projektet që kanë rëndësi më të madhe për publikun dhe komunën të mos realizohen.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia te zyrtarët kompetent për përgatitjen e plani vjetor të financimit të OJQ-ve, dhe të njëjtin ta dërgojnë në zyrën e Kryeministrit.

## 2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 12,881,813€, prej tyre ishin shpenzuar 8,905,889€. Ato kanë të bëjnë kryesisht për ndërtimin e rrugëve, kanalizimit, ndërtim shkolle, etj. Ne kemi testuar 78 mostra për teste substanciale në vlerë 4,390,369€, si dhe shtatë mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

**Çështja A3 - Mungesa e projekteve ekzekutive të ndërtimit**

**Gjetja** Sipas nenit 28.10 të LPP, Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në tre<sup>5</sup> nga gjashtë raste, procedurat e prokurimit të audituara, komuna ka filluar procedura të prokurimit dhe kishte lidhur kontrata pa hartuar paraprakisht projektin ekzekutiv të ndërtimit. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së njërive kërkuese pa bërë paraprakisht hartimin e projekteve ekzekutive zbatuese dhe mos funksionimi efikas të kontrolleve tek zyra e prokurimit duke zhvilluar procedurat pa u përmbushur kërkesat ligjore.

**Ndikimi** Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutues rezulton me anashkalim të kërkesës ligjore dhe mund të ndikoj në shpenzime të paparashikuara të buxhetit duke lidhur aneks kontrata për punët e paparashikuara.

**Rekomandimi A3** Kryetari të sigurohet se kontrollet funksionojnë në mënyrë efikase gjatë gjithë kohës nga zyra e prokurimit duke mos lejuar që të publikohen dosje të tenderëve pa projekte ekzekutuese.

---

<sup>5</sup> 1. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Mirofc, 2. Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Shajkofc, Batllavë, Sfeqel, Ballofc, Iladofc, Livadicë dhe Surkish, 3. Ndërtimi i Trotuareve (Loto I dhe II)

#### **Çështja A4 - Hartimi i specifikave teknike duke përdor emra tregtarë**

**Gjetja** Sipas nenin 28.7 të LPP, Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

Komuna për ndërtimin e emergjencës kishte lidhur kontratë 20.08.2019 në vlerë prej 519,689€. Me rastin e hartimit të specifikacionit teknik për dosje të tenderit, komuna në pesë raste brenda këtij specifikacioni ka përdorur emra tregtarë për produkte nga prodhues specifik. Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit efikas të kontrolleve nga zyra e prokurimit para se të publikohet dosja e tenderit.

**Ndikimi** Përdorimi i emrave tregtarë shkakton kufizimin e konkurrencës në një numër të vogël operator ekonomik, apo favorizon operator ekonomik të caktuar.

**Rekomandimi A4** Kryetari të sigurohet se kontrollet funksionojnë në mënyrë efikase gjatë gjithë kohës nga zyra e prokurimit duke mos lejuar që të publikohen dosje të tenderëve duke përdorur emra tregtarë për plotësimin e nevojave të komunës.

---

**Çështja A5 - Eliminim i operatorit ekonomik me ofertën më të lirë**

**Gjetja** Sipas nenit 7.1 të LPP, Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Komuna për ndërtimin e trotuareve nëpër disa fshatra Llot 2, kishte lidhur kontratë më datën 19.08.2019 në vlerë 331,177€, ndërsa kishte eliminuar operatorin ekonomik që kishte ofertën më të lirë me vlerë 255,447€. Eliminimi ishte bërë me supozimin se ka ofertuar çmime jo normalisht të ultë, mirëpo ky supozim nuk qëndron për faktin se operatori ekonomik i eliminuar ka çmime më të shtrenjta për pozicionet e kontestuara nga komuna, pra nuk kanë qenë çmime jo normalisht të ultë. Gjithashtu komuna nuk ka marr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga operatori ekonomik mbi procesin e prodhimit të elementeve të betonit nga fabrika të cilën e zotëronte apo minierën për nxjerrjen e gurit dhe përpunimin e gurit në pronësi të operatorit ekonomik të eliminuar. Komuna e kishte eliminuar ofertuesin më të lirë me arsyetimin se kishin vlerësuar totalin e ofertës dhe jo pozicionet. Ndërsa, shpjegimet nga OE i kishte kërkuar për pozicionet.

**Ndikimi** Mostrajtimi i barabartë i të gjithë operatorëve ekonomik përveç që është jo ligjore, ndikon edhe në dëmtim të buxhetit komunal.

**Rekomandimi A5** Kryetari të sigurohet se komisioni për vlerësimin e ofertave të tenderit i trajton të gjitha ofertat në mënyrë të barabartë dhe vlerësimi i ofertave për tender bëhet në pajtim me kriteret e dosjes së ofertës për tender dhe LPP. Gjithashtu zyrtari përgjegjës i prokurimit sigurohet se është duke u zbatuar LPP në tërësi duke ushtruar funksionin e kontrolli për parandalim dhe korrigjim të gabimeve.



---

**Çështja A6 – Pagesa e avansit në kundërshtim me ligjin e buxhetit**

**Gjetja** Sipas neni 13.5 të Ligji nr. 06/1 -133 mbi ndarjet buxhetore, paradhënia është e kufizuar deri në pesë përqind (5%) të vlerës së kontratës në muajin dhjetor të vitit 2019.

Me datë 10.12.2019, komuna kishte paguar si paradhënie 184,310€ për ndërtimin e bulevardit. Komuna kishte tejkalluar limitin ligjor duke paguar 8.12% të vlerës së kontratës. Vlera e tejkallimit ishte 70,818€. Sipas zyrtarëve komunal kjo ka ndodhur për shkak të konfuzionit të tyre në lidhje me kohën e nënshkrimit të kontratës dhe kohën e ekzekutimit të pagesës.

**Ndikimi** Pagesat përtej limiteve të lejuara nga Thesari kanë ndikim të drejtpërdrejt në disbalancimin e parave të gatshme në dispozicion për përdorim nga ana e organizatave buxhetore. Pagesat e tilla mund të sjellin komplikime në realizimin e projekteve organizatave tjera buxhetore si shkak i mungesës së parave të gatshme.

**Rekomandimi A6** Kryetari të sigurohet që çdo herë që paguhen avanse të respektohen kufizimet ligjore të përcaktuara me ligjin e buxhetit.

**Çështja A7 – Tejkallimi i kontratës kornizë**

**Gjetja** Sipas nenit 56.10 të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ e Prokurimit Publik A01, Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull dhe neni 38.2 të ligjit të prokurimit publik, Asnjë kontratë publike kornizë nuk do të ketë kohëzgjatje më shumë se 36 muaj. Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ripërtërihet dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen.

Për riparimin e rrugëve të asfaltuara komuna kishte lidhur kontratë kornizë më 28.06.2018 me afat deri më 28.10.2019. Edhe pse kjo kontratë kishte skaduar komuna kishte vazhduar me porositje të shërbimeve duke tejkalluar dy pozicione në vlerë 4,477€. Kjo sipas komunës kishte ndodhur për shkak nevojës së paraqitur për asfaltimin e një segmenti të rrugës.

**Ndikimi** Porositja e shërbimeve apo punëve dhe tejkallimi i pozicioneve pa një kontratë valide sipas procedurave të prokurimit përveç që nuk është ligjore, kjo praktikë eliminon konkurrencën e lirë dhe ndikon që buxheti të shpenzohet pa planifikim paraprak.

**Rekomandimi A7** Kryetari të sigurohet se çdoherë të ketë një kontratë të vlefshme sipas ligjit të prokurimit publik kur porositen shërbimeve apo punë të nevojshme. Po ashtu, të mos lejohet tejkallimi i sasive të parashikuara përtej limiteve të lejuara për kontratat kornizë.

---

## Çështja A8 - Dobësi në menaxhim të kontratës

**Gjetja** Sipas nenit 61.23 Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

Me rastin e realizimit të Zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit në disa fshatra menaxheri i projektit kishte aprovuar ndryshime të pozicioneve të kontratës pa një aprovim paraprak nga Zyrtari Kryesor Administrativ. Këto ndryshime të pozicioneve të kontratës kalonin 10% që lejohet me LPP. Kjo sipas zyrtarëve komunal janë bërë me qëllim që projekti në fjalë të jetë sa me efektiv dhe me i kompletuar sepse gjatë përpilimit të paramasës janë lëshuar gabime në disa raste edhe mungesa e gypit furnizues.

**Ndikimi** Mangësitë në menaxhimin e kontratave zvogëlojnë sigurinë që kontratat janë duke u realizuar në përputhje me kushtet dhe specifikat e kontratës. Mos respektimi i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit mund të rezultojë me pagesa të parregullta dhe vlerë të ulët për para.

**Rekomandimi A8** Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu edhe menaxheri i projektit duhet të veprojë në bazë të kompetencave me qëllim të respektimit të rregullave dhe mos tejkalimit të kompetencave.

## 2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 85,550,170€, pasurive jokapitale është 1,172,826€, si dhe e stoqeve 32,684€. Kemi testuar 112 mostra për teste substanciale në vlerë 4,562,618€, si dhe 9 mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

## Çështja A9 - Regjistri jo i plotë pasurive

**Gjetja** Neni 6, pika 3 i rregullores MF - nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se të gjitha Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK. Gjatë verifikimit të plotësisë së regjistrit të pasurive kemi gjetur se:

- 13 pagesa në vlerë 2,448,547€ për blerje të pasurisë kapitale gjatë vitit 2019 nuk ishin të regjistruara në regjistrin e pasurisë. Gjithashtu komuna nuk ka bërë regjistrimin e objektin të ri të komunës të ndërtuar nga Komisioni Evropian në vlerë prej 1,134,000€. Komuna nuk ka ofruar sqarime për mos regjistrim të pasurisë. Ndërsa mos regjistrimi i objektit të ri ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka mundur të siguroj dokumentacion të mjaftueshëm nga komisioni evropian.

- Pasuritë kapitale nën 1,000€, ishin mbivlerësuar për 135,390€, për faktin se këto pasuri ishin regjistruar në sistemin e-pasuria derisa kishin të bënin me pasuri kapitale mbi 1000€. Kjo ka ndodhur për shkak se regjistrat nuk mirëmbahen në mënyrë të rregullt nga zyrtari i pasurive për të bërë korrigjimet e nevojshme.

**Ndikimi**

Regjistrimi jo i plotë i pasurive dhe mos azhurnimi në regjistrat adekuat, ka ndikuar në nënvlerësimin e pasurive kapitale dhe jo kapitale të shpalosura në PFV.

**Rekomandimi A9** Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha blerjet dhe përvetësimet e pasurive kapitale regjistrohen saktë në regjistrin e pasurive nga zyrtari i pasurive në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë të pasurive.

---

## Çështja B2 - Parregullsi me regjistrat e Pasurisë

**Gjetja** Sipas Neni 22.3 të rregullores MF – nr. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit dhe nenit 7.1 Të gjitha lëvizjet e pasurive jo financiare (pranimi, shitja, dhurimi, transferimi dhe asgjësimi) të cilat rezultojnë në ndryshimin e përgjegjësisë menaxheriale dhe përdorimit duhet të mbështeten në dokumente përkatëse.

Edhe këtë vit në regjistrin e pasurisë kapitale, ishin 13 automjete transporti të regjistruara në vitin 2006, ndonëse gjashtë automjete ishin shitur përmes ankandit, derisa shtatë të tjera ende janë në përdorim. Vlera e përgjithshme e këtyre automjeteve ishte 25,250€ sipas vlerës fillestare pasi që nuk ishte aplikuar zhvlerësimi. Po ashtu në regjistër figuronin edhe tri automjete të njësisë së zjarrfikësve të regjistruara në vitin 2007, në vlerë të përgjithshme 10,500€. Sipas zyrtarit, dy prej tyre janë dorëzuar tek Agjencia për Menaxhim Emergjent ndërsa një automjet është shitur në ankand publik.

Pasuritë nën 1,000€ ishin paraqitur në PFV sipas vlerës fillestare, duke mos aplikuar fare zhvlerësimin

Për më tepër sistemi “e-pasuria” nuk përdoret fare nga sektori i shëndetësisë dhe arsimit.

Zyrtarët përgjegjës nuk kishin dhënë sqarime për mos zbatimin e rekomandimit nga viti i kaluar.

**Ndikimi** Mos azhurnimi i regjistrit të pasurive duke shlyer pasuritë e shitura apo të dhuruara dhe mos zhvlerësimit të tyre ka ndikuar që pasurit kapitale të mbivlerësohen.

**Rekomandimi B2** Kryetari të sigurohet se për pasuritë e shitura apo të dhuruara të merren veprimet e nevojshme që ato fshihen nga regjistrat e pasurive. Gjithashtu të sigurohet se regjistrohen të gjitha pasuritë në sistemin “e-pasuria” dhe fillon të aplikohet norma e zhvlerësimit.

---

## Çështja A10 – Mangësi në menaxhimin e pasurisë

### Gjetja

Sipas neni 4.1 të rregullores MF- nr. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën. Komuna nuk ka aprovuar rregulla dhe procedurave të brendshme për evidencën ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë të komunës.

Sipas neni 11.1 të rregullores MF – nr. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim dhe nenit 11.3 pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim dhe do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Në testimi i pagesave të blerjeve të pasurisë kapitale ne kemi hasur 15 projekt/pasuri me vlerë prej 942,899€ ishin pranuar teknikisht për përdorim, mirëpo në regjistra të pasurive janë të regjistruara në pjesë të ndara e jo si një pasuri/projekt i vetëm siç kërkohet me rregullore.

Sipas neni 19.4.3 të rregullores MF – nr. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare, përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është përgjegjës për krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe Identifikimi i pasurisë që nuk ka vlerë të bartur.

Komuna ka realizuar inventarizimin e pasurisë për vitin 2019, megjithatë raportet e inventarizimit nuk janë harmonizuar/krahasuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë dhe me regjistrin nga e-pasuria.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunës sa i përket fushës së pasurisë;

### Ndikimi

Mungesa e rregullave të brendshme dhe mos krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat pasurisë ka vështirësuar menaxhimin efektiv të pasurisë dhe për rrjedhojë vlera e paraqitur në PFV nuk është e saktë, pra nuk është prezantuar gjendja reale e pasurisë me të cilat disponon organizata.

### Rekomandimi A10

Kryetari të sigurohet se janë hartuar rregulla dhe procedura të brendshme për evidencën ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare. Pas përfundimit të çdo projektit zyrtari i pasurisë të sigurohet se bëhet regjistrimi i pasuri në përdorim. Gjithashtu të sigurohet se bëhen krahasimet e raporteve të inventarizimit me regjistrat pasurisë dhe të azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.

## 2.3 Të arkëtueshmet

OB-ja në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 7,756,104€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 2,933,624€, taksa në firmë 3,866,503€, qiraja komunale 940,474€ shfrytëzimi i hapësirave publike 12,700€, dhe tjera 2,803€. Llogaritë e arkëtueshme nga viti paraprak ishin rritur për 388,193€. Në këtë rritje e kanë ndikuar në masë të madhe të arkëtueshmet nga tatimit në pronë me vlerë 241,524€, taksa në firmë 72,267€ dhe qiraja komunale me 71,614€.

### Çështja B3 - Sfidat në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme

**Gjetja** Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e Llogarive të Arkëtueshme (LIA). Ne kemi raportuar edhe vitin e kaluar për mangësi të identifikuar si:

- Sipas nenin 26 të ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna për të arkëtueshmet në tatimin në pronë në vlerë 2,933,624€ nuk kishte ndërmarr ndonjë aktivitet për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme siç parashihet me ligjin për tatimin në pronë;

- Sipas nenit 22.2 të rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale, përcaktohet që të iniciohet procedura e ekzekutimit të dhunshëm në gjykatën kompetente dhe përmbarim privat mbledhja e llogarive të arkëtueshme.

Të arkëtueshmet nga taksat në biznes kishin arritur vlerën 3,866,503€. Komuna nuk kishte ndërmarr veprime të cilat parashikohen me rregullore, mirëpo iu kishte dërguar vërejtje vetëm barnatoreve të cilat edhe iu kishin përgjigjur vërejtjeve por jo edhe kategorive tjera të cilat kanë proporcion me të madh në llogari të arkëtueshme;

- Në kontratat e lidhura në mes të komunës dhe qiramarrësve janë paraparë masat që duhet të ndërmarrën në rast të mos pagesës së qirasë sipas kritereve të përcaktuara në kontratë.

Llogaritë e arkëtueshme që i përkasin pronave të lëshuara me qira janë 940,474€. edhe pse komuna për këto ka ndërmarr disa veprime por ato kanë qenë selektive dhe jo në proporcion me obligimet.

Sipas komunës gjendja ekonomike e sociale e komunës, ka sjell, deri te mos pagesa e borxheve tek tatimi në pronë, derisa sa i përket bizneseve aty ka shumë biznese joaktive.

**Ndikimi** Mos arkëtimi i të arkëtueshmeve ndikon që ato të bëhen të pa mbledhshëm duke krijuar një rast precedent për borxhlinjtë e tjerë të cilët mund të ndjehen të trajtuar në mënyrë jo të barabartë dhe gjithashtu rezulton fonde më pak për financimin e projekteve.

**Rekomandimi B3** Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve. Po ashtu duhet shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

## 2.4 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 285,089€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

### Çështja C1 - Vonesa në pagimin e faturave

**Gjetja** Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike pas pranimit të faturës.

Në një rast për mallra dhe shërbime dhe në pesë raste për investimet kapitale faturat e pranuar nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat ishin nga një deri në gjashtë muaj. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve.

**Ndikimi** Vonesat në realizimin e pagesave ndikojnë që Komuna të jetë subjekt të padive nga operatorët ekonomik, kështu duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore për Komunën.

**Rekomandimi C1** Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

## 2.5 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2019, ishte 95,884€, për të cilat komuna ishte në procese gjyqësore. Ne kemi testuar mostrën në vlerë 44,950€.

## Çështja A11 – Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente

- Gjetja** Sipas nenit 3.1.1 të rregullore MF - nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen. Komuna kishte prezantuar në listën e detyrimeve kontigjente vendimin e plotë fuqishëm të gjykatës prej 44,950€ për pagesën e tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të 21 punëtorëve të arsimit, duke mbivlerësuar detyrimet kontigjente.
- Ndikimi** Prezantimi jo i drejt i detyrimeve kontigjente ka bërë që detyrimet kontigjente të mbivlerësohen dhe të nënvlerësohen detyrimet e papaguara.
- Rekomandimi A11** Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet financiare të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

## 2.6 Detyrimet kontraktuese

Pasqyra e detyrimeve kontraktuese ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, nuk është ofruar nga Komuna e Podujevës. Këto detyrime janë për kontratat/marrëveshjet e nënshkruara për të cilat obligimet paguhen në vitet në vijim.

## 2.7 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në vitin 2019 ka operuar me një anëtar dhe i cili është Drejtor i njësisë. Komuna e Podujevës ka krijuar edhe Komitetin e Auditimit i cili kishte mbajtur pesë takime, që të ofrojë ndihmën e tij për NJAB-në.

NJAB përveç planit strategjik, kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë pesë auditime, të cilat edhe ishin realizuar sipas planit. Auditimet kanë mbuluar vitit aktual në fushën Prokurimit, tatimit në pronë, furnizimin dhe shpërndarjen e barnave, menaxhimin e personelit dhe planifikimin dhe menaxhimin nga lëmia e arsimit. Në këto pesë raporte ishin dhënë 20 rekomandime nga të cilat menaxhmenti 14 i kishte zbatuar dhe 6 ishin në proces të zbatimit.

## 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Komunës së Podujevës ka rezultuar në 20 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

OB ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të daluara nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.



Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 10 rekomandime janë zbatuar, një ishte në proces dhe tri nuk janë adresuar ende, derisa gjashtë rekomandime janë të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve)

**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019**

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në evidentimin e pasurive financiare dhe për të konfirmuar saktësinë e tyre. Gjithashtu, duhet të vendosen procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti.	Rekomandimi për vitin 2019 është dhënë tek nën kapitulli 2.2. Pasuritë kapitale dhe jokapitale.	Rekomandim i mbyllur
2	Realizimi i buxhetit	Kryetari, duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2018 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2019.	Kjo çështje nuk do të trajtohet në raportin e auditimit të vitit 2019.	Rekomandimi i mbyllur
3	Realizimi i buxhetit	Kryetari, duhet të marrë masa me kohë në mënyrë që të shmang pagesat e tilla që dëmtojnë buxhetin e komunës dhe shkaktojnë devijime. Po ashtu, duhet siguruar që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që mangësitë e njëjta të mos përsëriten ngase kjo çështje është theksuar edhe në të kaluarën.	Pagesat përmes vendimeve nuk janë trajtuar të realizimi i buxhetit.	Rekomandimi i mbyllur
4	Të hyrat	Kryetari, duhet të analizoj arsyet e mos realizimit të të hyrave dhe trendin e të hyrave gjatë viteve të fundit dhe në bazë të kësaj të bëjë një planifikim objektiv dhe të realizueshëm. Më tej, i njëjti plan duhet të pasohet me aktivitete dhe masa adekuate për zbatim dhe monitorim të planit.	Kjo çështje ndërlidhet me analizë financiare e cila nuk do të trajtohet në raportin e auditimit të vitit 2019.	Rekomandimi i mbyllur

5	Të hyrat	Kryetari duhet të shtojë funksionimin e kontrollit në këtë fushë, duke siguruar që të hyrat nga tatimi në pronë vlerësohen dhe menaxhohen bazuar në rregulloret përkatëse. Po ashtu të shikohet mundësia e kompensimit të palëve të dëmtuara.	Komuna ka bërë rregullimet e nevojshme në sistem për vlerësim sipas rregullores.	Rekomandim i zbatuar
6	Të hyrat	Kryetari, duhet të angazhohet që së bashku me Zyrën e financave dhe Departamentin e Tatimit në Pronë t'i largojë nga regjistri të dhënat e pasakta dhe të identifikohen pronat e privatizuara.	Komuna ka ndërmarr veprime që ti largoj të dhënat e pasakta.	Rekomandim i zbatuar
7	Të hyrat	Kryetari, duhet të siguroj se asnjë pronë publike nuk do të lejohet të shfrytëzohet pa pagesën e qirave të parapara me kontratë. Duhet të gjenden forma që të merren masa të menjëhershme që detyrojnë obliguesit të respektojnë detyrimet kontraktuale.	Kontrata në fjalë nuk ka filluar të zbatohet, andaj konsiderohet si rast i mbyllur.	Rekomandim i mbyllur
8	Pagat dhe mëditjet	Kryetari të sigurojë se janë dizajnuar kontrollet e duhura në mënyrë që rekrutimet të behen përmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat e konkursit.	Rekrutime e realizuara janë bërë në pajtim me rregulloret	Rekomandim i zbatuar
9	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.	Komuna vazhdon të angazhoj punëtore me kontrata të tilla. Shih çështjen B1	Rekomandim i pa zbatuar
10	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të forcojë kontrollet tek fusha e prokurimit dhe njësitë kërkuese në mënyrë që të bëhen planifikimet e duhura me kohë dhe që për çdo kontratë të procedohet sipas kërkesave ligjore të prokurimit në mënyrë që evitohen dobësitë në konkurrencë dhe të shmangen pagesat e parregullta.	Nga mostrat e testuara ne nuk kemi hasur në raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar

11	Subvencio net dhe transferet	Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të sigurojë që subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e vendosura në rregullore, në mënyrë që përfituesit të renditen sipas pikëve në bazë të cilave edhe marrin shumën e përcaktuar.	Të gjitha mostrat e testuara përfituesit ishin të renditur në listën e përfituesve .	Rekomandim i zbatuar
12	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj që komisioni për vlerësimin e tenderëve bën ekzaminimin e plotë të ofertave, dhe aty ku vërehen gabime aritmetikore apo nevoja për sqarime tjera nga OE, t'i informoj ata duke bërë ndryshimet e nevojshme brenda kufijve të lejuar.	Gjatë auditimit nuk kemi vërejtur raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar
13	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se punëve shtesë iu paraprinë aneks kontrata që përcakton saktë kushtet dhe çmimet e punëve apo shërbimit të përfituar.	Gjatë auditimit nuk kemi vërejtur raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar
14	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxheret e projektit kërkojnë nga kontraktuesit, aplikimin e librit ndërtimor, si mjet për ndërtim dhe zhvillim të projektit.	Në mostrat e testuara ne kemi vërejtur se mbahet libri ndërtimor.	Rekomandim i zbatuar
15	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se para fillimit të procedurave, të janë planifikuar projektet në tërësi, të zgjidhen të gjitha çështjet pronësore, në mënyrë që të mos ketë ngecje të projekteve dhe raportimin dhe aplikimin e ndëshkimeve në rast të vonesave të paarsyetuara.	Gjatë auditimit nuk kemi vërejtur raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar
16	Investimet kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se kërkesat e prokurimit duhet të përmbliidhen qartë dhe me kohë nga njësitë kërkuese për të eliminuar nevojën për procedura të shpeshta dhe përdorimin e procedurave minimale dhe kuotimin. Kjo duhet të bëhet duke planifikuar me kohë dhe duke u fokusuar në një proces efektiv të prokurimit që siguron vlerën për parane e shpenzuar.	Ne nuk kemi vërejtur se bëhet ndarje e tenderëve.	Rekomandim i zbatuar

17	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë në mënyrë efektive me zyrtarin e pasurive në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë të pasurive si dhe në përdorimin e sistemit e-pasuria. Sa i përket automjeteve të lartë cekura, kryetari duhet të formojë një komision në mënyrë që të sigurohen të gjitha informatat dhe bazuar në raportin e komisionit zyrtari i pasurisë të bëjë korrigjimin në regjistrin e pasurisë.	Nuk janë regjistruar të gjitha pasuritë dhe nuk përdoret E-Pasuria. Shih çështjen B2	Rekomandim i pa zbatuar
18	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve. Po ashtu duhet shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Komuna ka ndërmarr disa veprime për mbledhjen e Ll.A, mirëpo jo të mjaftueshme. Shih çështjen B3	Rekomandim i pa zbatuar
19	Obligimet e papaguara	Kryetari, duhet të sigurojë se është vendosur një sistem efikas ku faturat pranohen dhe raportohen saktë si për MF ashtu edhe për menaxhmentin. Po ashtu, në raportimet mujore duhet të përcjellët kronologjia e faturave të papaguara në mënyrë që faturat e papaguara të raportohen deri sa të paguhen dhe që menaxhmenti dhe Thesari të kenë informacionin e saktë për obligimet e mbetura.	Faturat janë prezantuar në PFV, mirëpo ende kishte vonesa në pagesën e tyre. Shih çështjen C1	Rekomandim në proces të zbatimit
20	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, lista e rreziqeve dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.	Kjo çështje nuk do të trajtohet në raportin e auditimit të vitit 2019	Rekomandim i mbyllur
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestininim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.		

2	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për detyra specifike të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se katër muaj. Po ashtu, pozitat e rregullta të punës të mos mbulohen me kontrata për detyra specifike dhe marrëveshjeve për shërbime të veçanta. Gjithashtu duhet të zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit për marrëveshjet për shërbime të veçanta
3	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia te zyrtarët kompetent për përgatitjen e plani vjetor të financimit të OJQ-ve, dhe të njëjtin ta dërgojnë në zyrën e Kryeministrit.
4	Investimet Kapitale	Kryetari të sigurohet se kontrollet funksionojnë në mënyrë efikase gjatë gjithë kohës nga zyra e prokurimit duke mos lejuar që të publikohen dosje të tenderëve pa projekte ekzekutuese.
5	Investimet Kapitale	Kryetari të sigurohet se kontrollet funksionojnë në mënyrë efikase gjatë gjithë kohës nga zyra e prokurimit duke mos lejuar që të publikohen dosje të tenderëve duke përdorur emra tregtarë për plotësimin e nevojave të komunës.
6	Investimet Kapitale	Kryetari të sigurohet se komisioni për vlerësimin e ofertave të tenderit i trajton të gjitha ofertat në mënyrë të barabartë dhe vlerësimi i ofertave për tender bëhet konfirmo kritereve të dosjes së ofertës për tender dhe LPP. Gjithashtu zyrtari përgjegjës i prokurimit sigurohet se është duke u zbatuar LPP në tërësi duke ushtruar funksionin e kontrolli për parandalim dhe korrigjim të gabimeve.
7	Investimet Kapitale	Kryetari të sigurohet që çdo herë që paguhen avanse të respektohen kufizimet ligjore të përcaktuara me ligjin e buxhetit.
8	Investimet Kapitale	Kryetari të sigurohet se çdoherë të ketë një kontratë të vlefshme sipas ligjit të prokurimit publik kur porositen shërbime apo punë të nevojshme. Po ashtu, të mos lejohet tejkalimi i sasive të parashikuara përtej limiteve të lejuara për kontratat kornizë.
9	Investimet Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu edhe Menaxheri i projektit duhet të veprojë në bazë të kompetencave me qëllim të respektimit të rregullave dhe mos tejkalimit të kompetencave.
10	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha blerjet dhe përvetësimet e pasurive kapitale regjistrohen saktë në regjistrin e pasurive nga zyrtari i pasurive në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë të pasurive.
11	Pasuritë	Kryetari të sigurohet se për pasuritë e shitura apo të dhuruara të merren veprimet e nevojshme që ato fshihen nga regjistrat e pasurive. Gjithashtu të sigurohet se regjistrohen të gjitha pasuritë në sistemin "e-pasuria" dhe fillon të aplikohet norma e zhvlerësimit.
12	Pasuritë	Kryetari të sigurohet se janë hartuar rregulla dhe procedura të brendshme për evidencën ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare. Pas përfundimit të çdo projektit zyrtari i pasurisë të sigurohet se bëhet regjistrimi i pasuri në përdorim. Komision për të inventarizimin pasurive të sigurohet se tërë pasuria është identifikuar dhe evidentuar në regjistrin e pasurisë dhe të bëhen

		harmonizimet dhe krahasimet e nevojshme për të identifikuar pasurit që nuk kanë vlerë bartëse dhe apo edhe pasuritë e dëmtuara.
13	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve. Po ashtu duhet shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.
14	Detyrimet e papaguar a	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.
15	Detyrimet kontigjent e	Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet financiare të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.



158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letër e Konfirmimit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno	21. 05. 2020	
Nr. orig. Org. led.	Nr. Bë.	Shtojcë - Prilog
02-016/01-00229/20		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm ne raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Podujevës, për vitin e perfunduar me 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

**Datë: 21 Maj 2020, Podujevë**

**Nexhmi Rudari**  
Nënkryetari i Komunës së Podujevës,

